



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2019

**V E N D I M**

**Nr. 119, Datë 09/09/2019**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar ankesën nr. 25, datë 20.03.2019, e Shoqatës së Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë, Qarku Durrës, përfaqësuar nga Znj. A.H., kryetare e kësaj shoqate, ku pretendohet diskriminim, për shkak të “aftësisë së kufizuar”, të invalidëve para dhe tetraplegjikë nga ana e Bashkisë Durrës.

Gjatë shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I :**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, rezulton se invalidëve para dhe tetraplegjikë nuk u sigurohet aksesimi fizik në mjetet e transportit publik në qarkun e Durrësit. Kryetarja e shoqatës së sipërpërmendur shprehet në ankesë se autobusët e shërbimit urban nuk kanë platform/rampë lëvizëse për të siguruar aksesin e personave me aftësi të kufizuar ose edhe kur e kanë refuzojnë ta vënë në dispozicion të individëve, që bëjnë pjesë në këtë kategori vunerabël. Znj. A.H. sqaron se ajo vetë e ka konstatuar një gjë të tillë, në mënyrë të drejtpërdrejtë, pasi kur ka kërkuar të përdorë shërbimin e transportit urban në linjën e transportit urban Durrës-Plepa, drejtuesi i autobusit jo vetëm ka refuzuar të ulë platformën, që i shërben personave me aftësi të kufizuar për të hipur në autobus, por nuk i ka dhënë as kohë, që ajo të mund të asistohet nga persona të tjerë për t’u ngjitur në autobus. Përveç kësaj, drejtuesi i autobusit ka përdorur shenja me gjestikulacione ofenduese, duke shprehur pakënaqësi dhe është larguar nga stacioni pa e ulur platformën. Një ngjarje e tillë ka ndodhur në datën 4 mars 2019, ora 13:45.

---

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën “LMD”.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën “KMD”.

Znj. A.H. shprehet se autobusi vijues, që është ndalur në stacion nuk ka patur platformë të pjerrët dhe në këto kushte, ajo është ndihmuar nga persona të rastit, të cilët e kanë ngritur dhe transportuar Znj. A.H. dhe karrocën e saj me rrota brenda autobusit.

Për sa më sipër, kryetarja e shoqatës së sipërpërmendur shprehet se sjellja dhe trajtimi i drejtuesit të autobusit të parë ishte fyes e denigrues, ndërkohë që edhe mungesa e aksesueshmërisë në autobusin e dytë të linjës së sipërpërmendur, ka cënuar rëndë dinjitetin e saj, si dhe e ka vënë para riskut, që të transportohej nga njerëz, që u gjendën pranë saj rastësisht, të cilët ishin të patrajnuar të operonin me karrocën me rrota.

Kryetarja e Shoqatës së Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë, dega Qarku Durrës shprehet se kjo situatë diskriminuese u ka ndodhur edhe individëve të tjerë, që ndodhen në kushte të njëjta me të dhe komuniteti i personave me aftësi të kufizuara vazhdimisht ankohet për sjellje diskriminuese në shërbimin e transportit urban qytetas dhe ndërqytetas në Durrës.

Subjekti ankues shprehet se këto situata ndodhin, si pasojë e moszbatimit të kuadrit ligjor ekzistues, por edhe si pasojë e mosndërrhyrjeve të njëjsteve të qeverisjes vendore, të cilat kanë detyrimin ligjor për organizimin, administrimin dhe financimin e transportit urban qytetas dhe ndërqytetas.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 25, datë 20.03.2019, e Shoqatës së Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë, Qarku Durrës, përfaqësuar nga Znj. A.H., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>3</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Bashkisë Durrës, me shkresën nr. 440/1, datë 01.04.2019, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
  - 1.** Informacion i hollësishëm mbi çështjen e parashtruar nga Shoqata e Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë, dega Qarku Durrës;
  - 2.** Informacion mbi mënyrën dhe masat e marra nga Bashkia Durrës, për të siguruar aksesin fizik të individëve me aftësi të kufizuara, në shërbimin e transportit publik;

---

<sup>3</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

3. Informacion, nëse mjetet e transportit urban, që operojnë në qytetin e Durrësit, kanë platforma të pjerrëta për të siguruar, aksesin e individëve me aftësi të kufizuara;
  4. Kopje të kontratave të lidhura me operatorët e shërbimit urban në qarkun Durrës;
  5. Informacion, nëse strukturat përkatëse të Bashkisë Durrës i kanë monitoruar paraprakisht automjetet e operatorëve të shërbimit urban, me të cilat ky institucion ka lidhur kontratë, për të evidentuar, nëse këto mjete kanë logjistikën e nevojshme për të siguruar akses për personat me aftësi të kufizuara. Nëse po, të dërgohet kopje e raportit të monitorimit dhe konstatimeve përkatëse;
  6. Mënyrën se si i monitoron Bashkia Durrës, mjetet e transportit urban qytetas dhe ndër-qytetas, lidhur me zbatimin e legjislacionit në fuqi mbi sigurimin e aksesit të individëve me aftësi të kufizuara në to;
  7. Informacion nëse pranë Bashkisë Durrës janë depozituar ankesa nga individë me aftësi të kufizuara, lidhur me çështje të ngjashme.
1. Në përgjigje të shkresës nr. 440/1, datë 01.04.2019, të Komisionerit, Bashkia Durrës dërgoi shkresën nr. 440/2, datë 16.04.2019, nëpërmjet së cilës sqaron se institucioni i Bashkisë Durrës ka zhvilluar disa vite më pare, konkursin për operatorët urbanë, që do të ofrojnë shërbimin urban qytetës, miratuar kjo me Vendim të Këshillit Bashkiak. Termat e referencës për këto konkurse janë përcaktuar, duke iu referuar legjislacionit në fuqi për transportin dhe mbi të gjitha në përmbushje të një shërbimi sa më cilësor për personat, që përdorin këtë shërbim. Këtu është specifikuar edhe kriteri, që mjetet duhet të jenë të pajisura me platforma lëvizëse, për përdorimin e këtij shërbimi nga personat me aftësi të kufizuara.

Monitorimi i mjeteve të transportit urban qytetas kryhet herë pas here, fizikisht, nga personat përgjegjës, si dhe nga ana e Policisë Bashkiake, lidhur me zbatimin e elementëve të kontratës si oraret, itinerari, shërbimi i ofruar ndaj personave që përdorin këtë shërbim etj. Ky shërbim, për sa i takon subjektit të ankesës së Znj. A.H., ka rezultuar i rregullt dhe mjetet e transportit publik qytetas të këtij subjekti janë të pajisura me platformën, që përdoret nga personat me aftësi të kufizuara, në rastet e monitoruara nga ana e Bashkisë Durrës.

Bashkia Durrës ka kryer monitorime në fushën e transportit, në përmbushje të funksioneve të saj, por deri më sot nuk ka patur ankesë me shkrim, lidhur me çështje të ngjashme.

Bashkëlidhur shkresës nr. 440/2, datë 16.04.2019, Bashkia Durrës ka dërguar kopje të kontratave të shërbimit të lidhura me operatorët e shërbimit urban për linjat e mëposhtëme:

1. Durrës-Unazë-Kënetë-Plepa-Durrës;
2. Durrës-Plepa-Durrës;
3. Durrës-Currila-Durrës;
4. Durrës-Universiteti-Durrës;
5. Durrës-Nishtullë-Durrës.

C. Në vijim të ndjekjes së procedurave të shqyrtimit administrativ, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 21.06.2019, ora 12:00, pranë Zyrës së KMD-së.

Bashkisë Durrës iu kërkua që në këtë seancë të paraqesë informacionin dhe aktet e mëposhtëme:

1. Urdhëri i Kryetarit të Bashkisë Durrës, nëpërmjet së cilit është ngritur grupi i punës, që kryen monitorimin e mjeteve të transportit publik qytetas dhe rrethqytetas;
2. Kopje të Raporteve të Monitorimit të hartuara nga grupi i punës;

Në seancë dëgjimore u paraqit Znj. A.H., Kryetare e Shoqatës së Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë, Qarku Durrës dhe dy përfaqësues të Bashkisë Durrës. Znj. A.H. parashtrori edhe një herë pretendimet e saj, duke u fokusuar tek mungesa e rampave tek mjetet e shërbimit urban, të cilat pengojnë aksesin e individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë në qytetin e Durrësit. Njëkohësisht, Znj. A.H. u shpreh se edhe ato automjete të shërbimit urban, të cilat ishin të pajisur me rampa të lëvizëshme, për të siguruar akses të individëve me aftësi të kufizuara, shpeshherë nuk përdoren nga drejtuesit e automjeteve. Ajo u shpreh se Bashkia Durrës nuk siguron zbatimin e legjislacionit ekzistues për të siguruar aksesueshmërinë e individëve para dhe tetraplegjikë në transportin urban qytetas. Znj. A.H. depozitoi në cilësinë e provës, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi disa foto automjetesh të shoqërisë Maren Bus sh.p.k., përkatësisht: (1) foto të automjetit me targë AA 692 TP, që ofron shërbimin urban qytetas, në linjën Plepa-Durrës-Plepa, i cili e ka plaformën që siguron aksesin e individëve me aftësi të kufizuar dhe nuk e ka përdorur ndaj Znj. A.H. dhe (2) foto të automjetit me targë AA 126 JH, që ofron shërbimin urban në linjën Durrës-Unazë-Kënetë-Plepa-Durrës, i cili nuk e ka platformën për individët me aftësi të kufizuar.

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës u shprehën se nuk ekziston një Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Durrës, nëpërmjet së cilit të jetë ngritur grupi i punës, që kryen monitorimin e mjeteve të transportit publik qytetas dhe rrethqytetas. Monitorimi fizik ndaj mjeteve të shërbimit urban kryhej nga ana e sektorit përgjegjës. Njëkohësisht, ata u shprehën se nuk janë mbajtur raporte monitorimi për inspektimet apo monitorimet e kryera në autobusët që ofrojnë shërbimin urban qytetas, si dhe nuk disponohet dokumentacioni përkatës. Në seancë u sqarua se Shoqëria Maren Bus sh.p.k., e cila siguron transportin urban në linjën qytetase Plepa-Durrës-Plepa dhe Durrës-Unazë-Kënetë-Plepa-Durrës, është një shoqëri që ka fituar konkursin e shpallur nga Bashkia. Një ndër kriteret e këtij konkursi ka qenë edhe aksesueshmëria fizike e personave me aftësi të kufizuar, në mjetet e transportit urban qytetas. Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës u shprehën se mjetet e transportit urban qytetas e garantojnë aksesin fizik të individëve me aftësi të kufizuar, por pavarësisht kësaj Bashkia Durrës do të kryente monitorime të mëtejshme. Nëse do të rezultonte e kundërta do të merreshin masat përkatëse, deri në heqje të licencës, së këtyre automjeteve. Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës u shprehën që në monitorimet e kryera deri më sot, nuk ka rastisur të këtë patur udhëtarë me aftësi të kufizuar, kështu që nuk është evidentuar përdorimi i rampave levizëse. Në seancë, Komisioneri konstatoi mungesën e raporteve të monitorimit,

akteve administrative nëpërmjet së cilëve kryhen monitorimet dhe dokumentacionit përkatës, pas kryerjes së monitorimeve. Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës u shprehën se pretendimet e tyre me shkrim do të dorëzoheshin në vijim të seancës dëgjimore.

1. Në kushtet kur gjatë seancës dëgjimore, si dhe gjatë hetimit të ankesës nr. 25, datë 20.03.2019, rezultoi se automjetet dhe punonjësit e shoqërisë Maren Bus sh.p.k., ishin të përfshira në këtë çështje, për efekt të shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri iu drejtua shoqërisë Maren Bus sh.p.k., me shkresën nr. 440/4, datë 27.06.2019 “Njoftim dhe kërkim për informacion”, duke e cilësuar palë në këtë proces shqyrtimi administrativ. Në këtë shkresë u vu në dukje fakti se në bazë të informacionit të përcjellë nga Bashkia Durrës, rezultonte se problematikat përkatëse të evidentuara në ankesë, i përkisnin automjeteve të kësaj shoqërie, e cila ofronte shërbimin urban qytetas në linjën Durrës-Unazë-Kënetë-Plepa-Durrës dhe Plepa-Durrës-Plepa<sup>4</sup>. Në shkresën e sipërpërmendur, Komisioneri i kërkoi këtij operatori, informacion mbi problematikën e parashtruar nga Znj. A.H., si dhe mbi çështjet e mëposhtëme:

- Sa është numri i automjeteve të shoqërisë Maren Bus sh.p.k , që ofrojnë shërbimin urban qytetas në Durrës?
- Sa prej këtyre automjeteve e kanë platformën përkatëse, për të siguruar aksesin e individëve me aftësi të kufizuar dhe sa prej tyre nuk e disponojnë këtë platformë?
- Pas kryerjes së verifikimeve, lidhur me ngjarjen e ndodhur në datën 4 mars 2019, ora 13:45, sipas fakteve të cituara në këtë shkresë, të përcillet informacioni përkatës pranë Komisionerit.
- Mënyra se si monitorohet nga ana e shoqërisë Maren Bus sh.p.k, sjellja dhe reagimi i shoferëve të automjeteve të shoqërisë, ndaj qytetarëve të cilëve u ofrohet shërbimi urban qytetas.

Komisioneri përcaktoi në shkresën e mësipërme si afat për dërgimin e informacionit të kërkuar, datën 05.07.2019. Shoqëria Maren Bus sh.p.k. nuk i dërgoi përgjigje shkresës nr. 440/4, datë 27.07.2019, të KMD-së, as brenda dhe as tej këtij afati.

2. Në vijim, Komisioneri iu drejtua sërish Shoqërisë Maren Bus sh.p.k. me anë të shkresës nr. 440/5, datë 30.07.2019.

Në shkresën e sipërpërmendur, Komisioneri i bën kujtesë subjektit të sipërpërmendur, për të dërguar informacionin e kërkuar brenda datës 05.08.2019, ose në rast të kundërt, në zbatim të pikave 13 dhe 15, të nenit 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, KMD do të marrë vendim me gjobë ndaj tij, masë, e cila do të përshkallëzohej,

---

<sup>4</sup> Referuar shkresës nr. 7064/1, datë 15.04.2019, të Bashkisë Durrës, si dhe Kontratave të Shërbimit Nr. 6731, datë 27.10.2014 dhe nr. 3879, datë 25.06.2014, të lidhura ndërmjet Bashkisë Durrës dhe Shoqërisë Maren Bus sh.p.k., të përcjella bashkëlidhur kësaj shkrese.

deri në kërkesë ndaj autoriteteve kompetente për heqje të liçencës për ushtrim të veprimtarisë së këtij subjekti.

- Sërisht, subjekti Maren Bus sh.p.k. nuk dërgoi përgjigje në adresë të Komisionerit.

3. Në këto kushte, mbështetur në nenin 32, pika 2 dhe nenin 33, pika 13, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri u shpreh me Vendimin nr. 112, datë 23.08.2019, nëpërmjet së cilit e gjobiti Shoqërinë Maren Bus sh.p.k., për mosdhënie informacioni.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës nr. 25, datë 20.03.2019, Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.**

Në ankesën nr. 25, datë 20.03.2019, së Shoqatës së Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë, Qarku Durrës, përfaqësuar nga Znj. A.H., kryetare e kësaj shoqate, pretendohet diskriminim, për shkak të “aftësisë së kufizuar”, të invalidëve para dhe tetraplegjikë nga ana e Bashkisë Durrës.

Pretendimi për diskriminim i shoqatës së sipërpërmendur mbështetet në faktin se në autobusat që ofrojnë shërbimin urban qytetas në qytetin e Durrësit dhe përkatësisht në linjat Plepa-Durrës-Plepa dhe Durrës-Unazë-Kënetë-Plepa-Durrës, nuk garantohet aksesueshmëria fizike e invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Mos ofrimi i lehtësive për këtë kategori individësh me aftësi të kufizuara fokusohet në dy aspekte: (1) automjetet nuk janë të pajisur me rampa të lëvizëshme, që mundësojnë aksesin fizik të individëve me aftësi të kufizuara dhe (2) automjetet janë të pajisura me rampa lëvizëse, ato nuk vihen në përdorim nga drejtuesit e autobuzëve për të siguruar akses fizik për këta individë. Rastet e parashtruara nga Znj. A.H. reflektojnë pikërisht mos ofrimin e këtyre lehtësive në transportin urban qytetas në qytetin e Durrësit. Gjatë hetimit administrativ të kësaj ankese, në cilësinë e subjektit kundër së cilit drejtohej ankesa u konsiderua edhe Maren Bus sh.p.k., autobusët e së cilës rezultuan se ofronin shërbimin urban qytetas në linjën, ku ankuesja ka patur probleme, të cilat lidhen me ofrimin e lehtësive për sa i përket aksesueshmërisë fizike në autobus.

Për sa më sipër, legjislacioni shqiptar siguron mbrojtje të të drejtave të kategorisë së individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët janë pjesë e grupit të individëve me aftësi të kufizuara. Ligji nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik” (i ndryshuar) parashikon detyrimin e shtetit për të krijuar kushte për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëlloj si të tjerët, duke siguruar për ta një nivel ekonomik të nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoze, kushte banimi, jetesë e punë të

përshtatshme, si dhe u krijon mundësi normale për kurim, arsimim, veprimtari çlodhëse, argëtuese dhe sportive.

Në kuptim të nenit 2, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik” (i ndryshuar), me “Paraplegjik” nënkuptohet çdo person që vuan nga paraliza e dy anësive të poshtme si pasojë e dëmtimit të palcës kurrizore nga shkaqe të ndryshme, ndërsa “Tetraplegjik” nënkuptohet çdo person, që vuan nga paraliza e katër anësive si pasojë e dëmtimit të palcës kurrizore nga shkaqe të ndryshme dhe i klasifikuar si i tillë me vendimin e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë. Në këtë kontekst, rezulton se aftësia e kufizuar e individëve, që i përkasin kësaj kategorie është e tillë, që kërkon në mënyrë të domosdoshme ofrimin e lehtësive për të patur aksesueshmëri fizike në mjetet e shërbimit urban e më gjerë. Pikërisht, për këtë arsye, ligjvënësi ka ofruar një sërë parashikimesh në akte të ndryshme ligjore dhe nënligjore që parashikojnë detyrimin e institucioneve përgjegjëgjese dhe subjekteve private për të mundësuar një gjë të tillë.

Neni 4, i ligjit të sipërpërmendur parashikon shprehimisht: “*Shteti mbron të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga të gjithë llojet e shfrytëzimit, të diskriminimit, të abuzimit dhe të fyerjes*”.

Parashikime të mëtejshme përmban ligji nr. 93/2014 “*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara*”, i cili ka si qëllim, të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes; të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri.

*Persona me aftësi të kufizuara*, sipas këtij ligji, janë, individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

*Jetesa e pavarur*, u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët. Ligji nr. 93/2014, përcakton se, një nga aspektet që siguron jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara është edhe transporti. Në gërmën “ë”, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 93/2014, parashikohet se: “*Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e, ndër të tjera, të kenë akses përkatësisht: ....ë) në transport....*”. Sipas nenit 6, të ligjit nr. 93/2014, jetesa e pavarur, mundësohet nëpërmjet shërbimeve të ndryshme që synojnë të ofrojnë mbështetje në kapërcimin e barrierave. Në këto shërbime përfshihen ndër të tjera edhe transporti.

Me qëllimin nxitjen e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në shoqërinë shqiptare, të parandalojë diskriminimin dhe të eliminojë pengesat për të pasur akses në shërbimet publike dhe realizimin e të drejtave të tyre, Qeveria shqiptare ka miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 483, datë 29.06.2016, “*Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020*”. Në analizën e situatës, për sa i përket aksesueshmërisë fizike, në Planin e Veprimit konstatohet se: “Nevojitet një transport i aksesueshëm, i përballueshëm dhe efikas për të bërë të mundur përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, për të lehtësuar lirinë e lëvizjes dhe për të nxitur pjesëmarrjen në punësim, arsimim dhe aktivitete të tjera.....”

Neni 85, i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar)<sup>5</sup> gjithashtu parashikon:

*“Është e detyrueshme të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që i përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jashtë qytetit, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e ndenjjes për ta.*

*Udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi dokumentin që përcakton ligji për ta...”*

Njëkohësisht, në referencë të neneve 13-14 të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar)<sup>6</sup> transporti qytetës është një shërbim i veçantë që plotëson nevojat e popullsisë së një qyteti, duke kryer shërbim të rregullt me autobusë brenda vijave kufizuese të tij ose duke lidhur qendra të rëndësishme ekonomike dhe sociale me pjesët e tjera të qytetit. Këshilli bashkiak, duke u mbështetur në nevojat për transport qytetës, është autoriteti përgjegjës që organizon, drejton, financon dhe kontraktton, sipas rastit, kryerjen e këtij transporti me autobusë brenda juridiksionit të vet.

<sup>5</sup> Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar me ligjin nr. 10/2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 37/2014 “Për disa shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 21/2013, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 10 302, datë 15.07.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9760, datë 21.06.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9373, datë 14.04.2005, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9096, datë 03.07.2003, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ndryshuar me ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002”, ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”).

<sup>6</sup> Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar me ligjin nr. 10/2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 37/2014 “Për disa shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 21/2013, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 10 302, datë 15.07.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9760, datë 21.06.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9373, datë 14.04.2005, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9096, datë 03.07.2003, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ndryshuar me ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002”, ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”).



Në këtë kontekst vlen të përmendet që edhe Vendimi nr. 1074, datë 23.12.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”, i cili përcakton masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjanohen pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara. Sipas këtij vendimi do të konsiderohen pengesa infrastrukturore: a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtdo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar, të përhershme ose të përkohshme; b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve e të pjesëve përbërëse; etj.

Në pikën 4, të këtij vendimi parashikohet: “Vendimi i sipërpërmendur e shtrin zbatimin e tij mbi: a) bashkitë dhe strukturat e tyre të kontrollit, sipërmarrësit privatë, administratorët e bizneseve, kompanitë e projektimit e të zbatimit të projekteve ndërtimore, si dhe të gjitha subjektet përgjegjëse për të garantuar një mjedis pa pengesa për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara; b) të gjitha ndërtimet e strukturat ndërtimore të reja dhe ekzistuese, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, kryesisht objektet e shëndetit publik, banesat dhe objektet rezidenciale, shkollat dhe institucionet shkencore, objektet kulturore, objektet e kultit, qendrat tregtare, institucionet administrative e të shërbimit publik, ndërmarrjet e qendrat e punës, në mjediset e të cilave ofrohen shërbime publike, parqet, sheshet e rrugët; c) mjetet e transportit publik; ç) mediat dhe tërësinë e mjeteve publike apo private të informimit publik.”

Pikat 6 dhe 7, të këtij Vendimi përcaktojnë se shërbimi dhe mjetet e transportit publik duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë, si dhe njësitë vendore përgjegjëse për transportin publik, qytetas dhe ndër-qytetas, duhet të publikojnë apo afishojnë në çdo stacion të mjeteve të transportit publik orarin e lëvizjes së mjeteve të përshtatura dhe monitorojnë zbatimin e tij.

Në pikën 9 të saj, VKM-ja e sipërpërmendur parashikon se shërbimet e transportit publik ofrojnë transport qytetas me mjete tërësisht të përshtatura, minimumi çdo 1 (një) orë në çdo vendqëndrim dhe shërbim transporti ndër-qytetas me mjete të përshtatura për personat me vështirësi në lëvizje, minimumi një herë në ditë.

Njëkohësisht, në këtë kuadër vlejnjë të përmenden edhe parashikimet e Vendimi nr.1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”. Neni 26, i kësaj VKM-je parashikon shprehimisht: 1. Në mjetet e transportit si tramvaji, autobusi, metro, rezervohen të paktën tri vende për t’u ulur personat me aftësi të kufizuara lëvizëse në afërsi të portës së daljes. 2. Personave me aftësi të kufizuara lëvizëse ju lejohej hyrja dhe nga porta e daljes.3. Në brendësi të mikrobusit të shkollës duhet të jetë rezervuar një hapësirë me gjerësi që të lejojë qëndrimin e karriges me rrota, pa penguar kalimin. Kjo hapësirë duhet të jetë e pajisur me ganxha, të vendosura në mënyrë të përshtatshme për të kryer bllokimin e karriges me rrota. 4. Mjetet e

*caktuara për transportin e përbashkët të personave në rrugë për përdorim publik duhet t'i përgjigjen karakteristikave të ndërtimit të përcaktuara me akte ligjore në fuqi.5. Vagonat e trenit brenda tyre duhet të jenë të pajisur në mënyrë të përshtatshme për të lejuar sistemimin e një invalidi në karrige me rrota, dhe të vendosen në përbërje të trenave të linjave kryesore.”*

Sikurse vihet re nga kuadri ligjor i sipërpërmendur, sigurimi i aksesueshmërisë për individët me aftësi të kufizuara, dhe në rastin konkret individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë konsiderohet prioritar. Në rastin e transportit urban qytetas përgjegjësia për të monitoruar plotësimin e kriterit të aksesueshmërisë fizike të automjeteve të transportit urban është e njëjësive të qeverisjes vendore. Në pikën 6, të nenit 23 *“Funksionet e Bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike”*, të ligjit nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”* parashikohet: *“Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: ...6. Transportin publik vendor”*.

Neni 26, i ligjit të sipërpërmendur, parashikon: *“Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve: 1. Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.”*

Për sa më sipër, referuar Kontratave të Shërbimit Nr. 6731, datë 27.10.2014 dhe nr. 3879, datë 25.06.2014, të lidhura ndërmjet Bashkisë Durrës dhe Shoqërisë Maren Bus sh.p.k., rezulton se ky operator shërbimi ofron shërbimin urban qytetas për linjat Durrës-Unazë-Kënetë-Plepa-Durrës dhe Durrës-Plepa-Durrës. Ngjarjet e ndodhura dhe problematika e parashtruar nga Znj. A.H. kanë të bëjnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me mos sigurimin dhe mos ofrimin e shërbimit për aksesueshmërinë fizike në autobusët e këtij operatori. Në bazë të kontratave të mësipërme rezulton se ato përmbajnë parashikime, lidhur me detyrimin e operatorit të shërbimit për ofrimin e lehtësirave dhe sigurimin e aksesueshmërisë fizike të individëve me aftësi të kufizuara. Në nenin 12 të Kontratave të sipërcituara parashikohet: *“Operatori detyrohet që:....- Të sigurojë vende të rezervuara vecanërisht për personat me aftësi të kufizuara, gratë shtatëzënë, të moshuarit”*. Në nenin vijues parashikohet: *“...të ketë ulje të njëanshme nga ana e pasagjerit, kur autobusi është i ndaluar në stacion”*.

Pavarësisht sa më sipër, gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se Bashkia Durrës nuk ka monitoruar zbatimin e kontratave të lidhura me operatorin Maren Bus sh.p.k., pasi ajo nuk ka depozituar në cilësinë e provës pranë KMD-së, asnjë raport monitorimi të autobusëve të dy linjave të mësipërme, si para edhe pas seancës dëgjimore<sup>7</sup> të zhvilluar pranë Komisionerit, mbi këtë çështje. Neni 82, pikat 2 dhe 3 të Ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Proçedurave Administrative i*

---

<sup>7</sup>Referuar proçesverbalit të seancës dëgjimore rezulton se përfaqësuesit e Bashkisë Durrës janë shprehur se në vijim të saj do të zhvillohet kontrolle në autobusët e linjave qytetase dhe do të merren masa ndaj operatorëve të shërbimit urban që nuk ofrojnë aksesueshmëri fizike për personat me aftësi të kufizuara.

Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar)<sup>8</sup> ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në rastin konkret Bashkisë Durrës. Në këtë rast, Bashkia Durrës duket të provonte se nga ana e saj janë marrë të gjitha masat e nevojshme për garantimin aksesueshmërisë fizike në transportit qytetës për personat me aftësi të kufizuar, si dhe të evidentonte qartësisht kontrollet dhe monitorimet e kryera ndaj operatorit të shërbimit urban qytetas Maren Bus sh.p.k, apo edhe ndaj operatorëve të tjerë, si dhe masat respektive të marra ndaj subjekteve që kanë rezultuar se nuk kanë zbatuar parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore të sipërpërmendura dhe kontratave të shërbimit.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1, të LMD, Komisioneri gjykon se individët paraplegjikë dhe tetraplegjikë të qytetit të Durrësit i janë nështruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, nga ana e Bashkisë Durrës.

Njëkohësisht, Komisioneri gjykon se operatori urban Maren Bus sh.p.k., duke u bërë palë në këtë procedim administrativ, refuzoi të bashkëpunojë me Komisionerin dhe njëkohësisht, në kushtet kur ky subjekt ka patur barrën e provës për të vërtetuar, se ai ka zbatuar parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe të kontratave të shërbimit të lidhura me Bashkinë Durrës, mbi sigurimin e aksesueshmërisë fizike të individëve me aftësi të kufizuar dhe nuk ka dhënë informacionin e kërkuar, prezumon faktin se pretendimet e Znj. A.H. janë të vërteta.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se në kuptim të nenit 7, pika 1, të LMD, operatori urban Maren Bus sh.p.k. ka ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë dhe disfavorizues, individët që i përkasin kategorisë paraplegjikë-tetraplegjikë, duke mos siguruar dhe duke refuzuar të ofrojë aksesueshmërinë fizike të tyre në mjetet e shërbimit urban, që ky operator përdor për të ofruar shërbimin urban qytetas në qytetin e Durrësit.

## **B. Shkaku i mbrojtur.**

Në ankesën nr. 25, datë 20.03.2019, e Shoqatës së Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë, Qarku Durrës, përfaqësuar nga Znj. A.H., kryetare e kësaj shoqate, pretendohet diskriminim, për shkak të “aftësisë së kufizuar”, të invalidëve para dhe tetraplegjikë nga ana e Bashkisë Durrës.

*“Aftësia e kufizuar” është njëri prej shkaqeve, për të cilët, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen*

<sup>8</sup> Neni 82, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) parashikon: “2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. 3. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund t’i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e procedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme.”

*ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Në lidhje me pretendimin e palës ankuese për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, Komisioneri gjykon se “aftësia e kufizuar” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme, që e justifikojnë si të tillë, pasi kategoria e invalidëve para dhe tetraplegjikë është me aftësi të kufizuara.

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me “aftësinë e kufizuar”.**

Invalidët para dhe tetraplegjikë janë një kategori e grupit të personave me aftësi të kufizuara, si të tillë gëzojnë një sërë të drejtash në bazë të legjislacionit në fuqi.

Për sa më sipër, Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”<sup>9</sup> në mënyrë të posaçme në nenin 4/1, ka përcaktuar se: “Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, për të gjithë personat me aftësi të kufizuar, pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar.”

Njëkohësisht mbështetur në Komentin e Përgjithshëm të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, aksesueshmëria është konsideruar si një faktor themelor për zbatimin e Konventës “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”. Duke qenë se aksesueshmëria përbën parakusht që personat me aftësi të kufizuara të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në shoqëri, mohimi i aksesit në mjedis, transport, teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, në shërbimet e hapura për publikun duhet të shihet gjithmonë si diskriminim, sipas këtij Komenti.

Nën frymën e Konventës së sipërpërmendur, sikurse është përmendur edhe në paragrafët e mësipërme, ligjvënësi ka miratuar një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore që mbrojnë shprehimisht të drejtën e individëve me aftësi të kufizuar për aksesueshmëri fizike e më gjerë, në fusha të ndryshme, sikurse edhe në atë të transportit.

Në referencë të nenit 3, të ligjit nr. 93/201, datë 24.07.2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, “aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve. Sipas këtij ligji, ndër të tjera, me “pengesa” nënkuptohen edhe pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike.

---

<sup>9</sup>Ratifikuar me ligjin nr 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

Neni 20, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” siguron mbrojtje te individëve nga diskriminimi në fushën e të mirave e shërbimeve. Neni 20, parashikon shprehimisht:

“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:

a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

.....

f) lehtësi për transport ose udhëtim;

g) shërbimet e profesioneve të lira.

3. Ndalohet për një person fizik ose juridik, që ofron të mira dhe shërbime për publikun, të mos pranojë ose të kundërshtojë realizimin e ndryshimeve ose përshtatjeve të nevojshme dhe të duhura, të cilat synojnë të mundësojnë përfitimin e këtyre të mirave dhe shërbimeve nga një person me aftësi të kufizuara, për sa kohë që këto modifikime apo përshtatje nuk imponojnë një barrë të shpërpjesëtuara ose të paligjshme mbi personin që ofron të mirat dhe shërbimet.

4. Refuzimi, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshin edhe situata kur refuzimi në fakt bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, por nga subjekti diskriminues deklarohen shkaqe të tjera, apo nuk deklarohet asnjë arsye si shkak i refuzimit.....”

Në rastin konkret, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje rezultoi se një pjesë e mjeteve të transportit publik të operatorit urban Maren Bus sh.p.k., të kontraktuar nga Bashkia Durrës, ishin të pajisur me platformën lëvizëse, që siguron aksesueshmërinë fizike të personave me aftësi të kufizuara në autobusë, ndërkohë që një pjesa tjetër e këtyre automjeteve nuk janë të pajisur me një pajisje të tillë, duke e diskriminuar këtë kategori individësh, për shkak të aftësisë së kufizuar. Mungesa e një platforme lëvizëse në autobusët e kësaj shoqërie, përbën një pengesë në kuptimin e ligjit nr. 93/201, datë 24.07.2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, pasi pengon aksesin fizik në automjetet urbane qytetase, të individëve me aftësi të kufizuara, duke kufizuar mundësinë e tyre për të vetëvepruar.

Njëkohësisht, në kushtet kur ankuesja pretendon se edhe ato automjete që kanë platformë lëvizëse, refuzojnë ta vënë në përdorim për të siguruar aksesin fizik të individëve me aftësi të kufizuara në autobusë dhe nga ana e Shoqërisë Maren Bus nuk është dhënë asnjë fakt dhe provë për të vërtetuar të kundërtën, Komisioneri gjykon se kjo shoqëri ka diskriminuar sërish

kategorinë e individëve paralegjikë dhe tetraplegjikë, për shkak të aftësisë së kufizuar. Nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve të tilla, Shoqëria Maren Bus sh.p.k. bie ndesh me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, sikurse edhe me detyrimet kontraktore.

Për sa më sipër, shërbimi urban qytetas është një shërbim publik, i cili, sikurse është përmendur me sipër, menaxhohet nga njësitë e qeverisjes vendore dhe në rastin konkret nga Bashkia Durrës. Detyrimi për të monitoruar dhe kontrolluar zbatimin e parashikimeve të akteve të sipërpërmendura dhe përcaktimeve në kontratat e shërbimeve ka qenë detyrim i Bashkisë Durrës, e cila ka gjithashtu tagrin për të licencuar operatorët e shërbimit urban<sup>10</sup> dhe për të marrë masa ndaj tyre në rast mospërbushje të detyrimeve ligjore dhe atyre kontraktore. Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri konstatoi se Bashkia Durrës nuk ka vepruar në bazë të kompetencave, që asaj i atribuohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për të ndaluar faktin e mos ofrimit të lehtësirave në transport për kategorinë e individëve paralegjikë dhe tetraplegjikë. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se ky institucion nuk i ka kryer detyrimet e tij, duke diskriminuar individët paralegjikë dhe tetraplegjikë për shkak të aftësisë së kufizuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 18, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (të ndryshuar), ligjin nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nenin 6 e nenin 20, të ligjit nr.93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”, nenin 85, të ligjit 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, neneve 2 dhe 4 të ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statuti i invalidit paralegjik dhe tetraplegjik” (i ndryshuar), nenin 23, pika 6 dhe nenin 26, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit të individëve paralegjikë dhe tetraplegjikë të qytetit të Durrësit, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga Bashkia Durrës.
2. Konstatimin e diskriminimit të individëve paralegjikë dhe tetraplegjikë të qytetit të Durrësit, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga operatori i shërbimit urban qytetas Maren Bus sh.p.k.

---

<sup>10</sup> Shih Udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”.

3. Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e Bashkisë Durrës, për të garantuar aksesueshmërinë fizike të kategorisë së individëve paraplegjikë e tetraplegjikë, në automjetet e shërbimit urban qytetas.
4. Në referencë të pikës 2, të këtij Vendimi, të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e operatorit urban Maren Bus sh.p.k., për të garantuar aksesueshmërinë fizike të individëve paraplegjikë e tetraplegjikë, në automjetet e shërbimit urban qytetas, sipas legjislacionit në fuqi.
5. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë Vendim, Bashkia Durrës dhe operatori urban Maren Bus sh.p.k., të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
6. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
7. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Robert GAJDA**

**KOMISIONER**

Fusha – te mira dhe shërbime  
Shkak – aftesi e kufizuar